

PROCESVERBAL

Nga seanca e dytë (2) e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më 20 janar 2022, me fillim nga ora 10:00, me këtë rend të ditës:

REND DITE

1. Zgjedhja e Nënkyetarit për Komunitete të komunës së Dragashit.

g.Uran Halimi – Përsëhendetje, të nderuar delegatë, kryetar dhe të gjithë të pranishmit. Po e hapi seancën e dytë për këtë vit, në të cilën siç e dini në rend dite kemi vetëm një pikë, e cila është: Zgjedhja e Nënkyetarit nga Komunitetet të komunës së Dragashit. Pa humbur kohë kalojmë në votimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Kush është: Pro-13. Kundër-13. Abstenim-0.

Siç e shihni kemi vota të barabartë, 13 delegatë janë pro, 13 kundër. Nuk ka abstenim, andaj vota ime e dytë në cilësinë e kryesuesit të Kuvendit është vendimtare, unë, sërish jam kundër mbajtjes së kësaj seance me këtë pikë të rendit të ditës.

Duke pasur parasysh se shumica është kundër vazhdimit të kësaj seance me këtë rend dite dhe meqenëse nuk kemi ndonjë pikë tjetër në rend dite, dëshiroj të shtoj një pikë në rendin e ditës, ku na kanë dërguar nga Qendra në lidhje me delegatët e Kuvendit, kemi një kërkesë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për të deleguar 3 delegatë të kuvendit tonë në këtë organizatë. Formula që na dërguan thotë që ne delegojmë një për çdo 10 delegatë. Kuvendit të Komunës së Dragashit i takon 3 delegatë, të cilët duhet t'i zgjedhim, një i LDK-së, një i PDK-së dhe një nga radhët e komunitetit joshumicë.

Jeni pro vendosjes së kësaj pike në rend dite? Meqenëse nuk jeni pro, e deklaroj këtë seancë të mbyllur.

Përgatiti:

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi i seancës:

Uran Halimi